

REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43 pika 4 të Rregullave Financiare dhe Shpenzimet e Thesarit 02-Shpenzimi i Parave Publike, dt.31 mars 2009 dhe nenit 17 pika 1.1 të Rregullores së Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë Nr.01/2018 për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione personave juridikë – OJQ dhe ndihmë momentale personave fizikë Nr.144/18 dt.31.05.2018, më datën 30.08.2018 arrihet kjo:

**MARRËVESHJE E MIRËKUPITIMIT
PËR SHFRYTËZIM TË MJETEVE FINANCIARE NGA FONDI PËR
TRANSFERE DHE SUBVENCIONE**

Në mes të:

1. Komunës së Vushtrrisë, të cilën e përfaqëson z. Xhafer Tahiri, Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtejshëm Komuna), dhe
2. Klubit të Hendbollit Vushtrria (M), të cilin e përfaqëson z.Sadik Xhema, përfitues i mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione (në tekstin e mëtejshëm Përfituesi).

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje është mbikëqyrja e shfrytëzimit të mjeteve financiare të shpërndara nga fondi për transfere dhe subvencione të buxhetit të Komunës gjegjësisht përfitimi sipas kritereve të parapara me rregullore të Kuvendit të Komunës.

Neni 2

Obligimet e palëve

1. Obligimet e Komunës

- 1.1.Komuna do të ndaj mjete financiare buxhetore nga fondi për transfere dhe subvencione në shumën prej 500 € (pesëqind euro) në emër dhe llogari të Klubit të Hendbollit Vushtrria (M) përfitues, në bazë të vendimit të Kryetarit 02Nr.1086/18, dt. 30.08/2018.
- 1.2.Komuna do të bëjë pagesën nga paragrafi paraprak, në bazë të ligjit dhe rregulloreve në fuqi.
- 1.3.Komuna do të monitoroj procesin e shfrytëzimit të mjeteve dhe destinimin e tyre.

2.Obligimet e Përfituesit

- 2.1.Përfituesi do t'i shfrytëzoj mjetet financiare të fondit për transfere dhe subvencione për qëllimin e caktuar sipas planit apo specifikacionit të shpenzimeve të paraqitura me shkrim nga përfituesi.
- 2.2.Përfituesi do të raportojë në Komunë për shpenzimet e mjeteve të përfituara, në afat prej 45 ditësh pas përfundimit të projektit.
- 2.3.Përfundimisht, nëse afati nga pika paraprake për shkak të natyrës është i pa zbatueshëm, me arsyetim të përfituesit ky afat mund të zgjatet për aq kohë të arsyeshme sa do të nevojitet për realizim të projektit.

Neni 3 Zgjidhja e Marrëveshjes

Në rast të mos përmbushjes së obligimeve të kësaj marrëveshje në kohë të caktuar, atëherë e njëjta do të zgjidhet me vet të drejtën.

Neni 4 Kohëzgjatja e Marrëveshjes


Kjo marrëveshje do të jetë valide dhe e plotfuqishme gjer në përmbushjen e obligimeve nga të dyja palët.

Neni 5 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit është përpiluar në një ekzemplar për secilën palë dhe do të hyj në fuqi pas nënshkrimit nga palët.

Nënshkruar më, 30.08.2018.

Sadik Xhema



Nënshkruetit



Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës

